



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 443/25, Datë: 23.04.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 136 të mbajtur më 14.04.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet programi i studimeve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 - *Menaxhim Biznesi (Gjuhë Shqipe dhe Boshnjake), MSc 120 ECTS me 2 specializime:*
 1. *Menaxhim Biznesi, 2. Banka dhe Financa, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
- II.** Akreditohet programi i studimeve i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Menaxhim në Turizëm dhe Hotelieri (Gjuhën shqipe dhe boshnjake), BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 105 studentë për vit akademik;*
- III.** Riakreditohet programi i studimeve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre(3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc 180 ECTS R me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- IV.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI.** Obligohet Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VII.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhim Biznesi (në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Boshnjake) MSc 120 ECTS, me 2 specializime: 1. Menaxhim Biznesi, 2. Banka dhe Financa (120 ECTS).</i>	Enkeleda Lulaj Bashkim Nurboja Emin Neziraj
2.	<i>Menaxhim në Turizëm dhe Hotelieri (në gjuhën shqipe dhe gjuhën boshnjake), BSc (180 ECTS)</i>	Anela Dzogovic Hajrija Shkrijel Merita Dauti Bedri Millaku
3.	<i>Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc (180 ECTS) R</i>	Ismajl Cacaj Nazmi Hasanaj Dëfrime Berisha

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Biznesi (në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Boshnjake), Master i Shkencave MSc 120 ECTS, me 2 specializime*** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 31.01.2025 me këtë përbërje: Andrea Serban, Marina Gregoric dhe Giga Khositashvilli. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Menaxhim në Turizëm dhe Hotelieri (në gjuhën shqipe dhe gjuhën boshnjake), BSc (180 ECTS)***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 31.01.2025 me këtë përbërje: Andrea Serban, Marina Gregoric dhe Giga Khositashvilli. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.
Akreditimi i programit *Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje (në gjuhën shqipe dhe gjuhën boshnjake), BSc (180 ECTS)*, vetëm për tri vite është bërë për faktin se ky program akreditohet për herë të parë, dhe sipas nenit 35, paragrafit 2 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, citojmë: *Kohëzgjatja e akreditimit të programit është tre (3) vjet. Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet.*
- Për programin e studimit; *Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc 180 ECTS*** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 19.02.2025 me këtë përbërje: Reiner Doluschitz, Jasna Novak dhe Juraj Bogat. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) fushë të e standardeve të akreditimit dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të e standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 136-të, të mbajtur më datë 14.04.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

